




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORI AUTORITETI ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



NR.01/2026



## UDHËZIM ADMINISTRATIV NËR. 01/2026 PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSËS VJETORE TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË

Neni 1  
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e taksës vjetore të licencimit dhe metoda e kalkulimit të saj, të cilën Ofruesit e Shërbimeve të Ujit të licencuar nga ARRU janë të obliguar ta paguajnë nga faturimi i tyre bruto vjetor.

Neni 2  
Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ përcakton temat, kushtet dhe procedurat për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit, të Ujërave të Ndolura dhe Furnizuesit e Ujit me Shumicë (në vijim: "Ofrues të Shërbimeve"). Në rast bashkimi (shkrirje) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve, pasardhësi i tij merr përsipër detyrimet për pagesën e taksës sipas këtij Udhëzimi.

Neni 3  
Taksa e Aplikimit për Licencë

Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar t'i paguajë ARRU-së taksën e pakthyeshme të paraparë me nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-042, në shumën prej **200.00 € (dyqind euro)**, për paraqitjen e aplikacionit për lëshimin ose përtëritjen e licencës. Paguesa kryhet në ditën kur aplikacioni për licencë i dorëzohet ARRU-së.

**Neni 4**  
**Taksa Vjetore e Licencimit**

- Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU taksën e pakthyeshme vjetore të licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2026 në pajtim me nenin 14 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-042.  
Lartësia vjetore e Taksës së licencimit është përcaktuar të jetë **0.95 %** e bruto faturimit vjetor të raportuara në pasqyrat e të ardhurave të tyre për vitin 2024 të atij Ofruesi të Shërbimeve të Ujit sipas shtojcës dy (2) të këtij udhëzimi.

$$\underline{X = B \times 100/t}$$

*X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve*

*B = Shpenzimet e parapara të ARRU për vitin 2026 (shih Shtojcën 1)*

*t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin 2024 (shih Shtojcën 2)*

- Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve të Ujit, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që është bashkuar (shkrirë).
- Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, dhe furnizuesit të ujit me shumicë, të Licencuar nga ARRU janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12) kështe të barabarta në çdo fillim të muajit të vitit kalendarik më së voni deri më datën pesë (5) të çdo muaji.

**Neni 5**

**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.01/2025 për përcaktimin e lartësisë së taksës vjetore për vitin 2025.

**Neni 6**  
**Hyryja në Fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Lartësisë së Taksës Vjetore të Licencimit hyn në fuqi më **1 janar 2026**.

Datë 12 / 12 / 2025  
Prishtinë

  
Drejtoresha e ARRU  
Hajrije Morina

**Bashkangjitur në këtë udhëzim janë edhe shtojcat si në vijim:**

*Shtojca 1: Shpenzimet ARRU—s sipas kufijve të fortë të buxhetit për vitin 2026*

*Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2024 të audituara dhe*

*Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2026*

*Shtojca 1: Shpenzimet Totale të ARRU-së sipas kufijve të fortë buxhetor për vitin 2026*

<b>SHPENZIMET TOTALE TË ARRU NË 2026</b>	
<b>1. Shpenzimet e Personelit</b>	<b>260,678.00 €</b>
<b>2. Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve</b>	<b>143,000.00 €</b>
<b>3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike</b>	<b>6,503.00 €</b>
<b>4. Investime Kapitale</b>	<b>0.00 €</b>
<b>Gjithsej - Shpenzimet e ARRU:</b>	<b>410,181.00 €</b>

*Shënjca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve për vitin 2024 (i audhuar nga ARRU) dhe Taksa Vjetore e Licencimit për vitin 2026*

SHËRBIMET E UJIT, UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË - 2024			TAKSA VJETORE E LICENCIMIT PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE PËR VITIN 2026		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Lartësia e takses vjetore
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtinë	16,622,645.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtinë	158,030.99
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	2,894,896.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	27,501.51
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	5,027,075.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	47,757.21
Ofresi i Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI" sh.a.	Prishtinë	1,447,559.00 €	Ofresi i Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI" sh.a.	Prishtinë	13,751.81
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "MITROVICA" sh.a.	Mitrovicë	4,295,425.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "MITROVICA" sh.a.	Mitrovicë	40,806.54
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	4,608,328.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	43,779.12
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	5,758,717.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	54,707.81
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	2,510,107.00 €	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	23,846.02
<b>Totali – Ofruesit shërbimeve te Ujit</b>		<b>43,164,752.00 €</b>	<b>Total taksa vjetore 2026</b>		<b>410,181.00€</b>